



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5122/Prot.

Tiranë, më 4. 8. 2023

URDHËR

Nr. 456, Datë 4.8.2023

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER I SHKENCAVE NË "MARITIME ENVIRONMENTAL PROTECTION
AND MANAGEMENT", NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS,
NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË DHE NË UNIVERSITETIN E
MALIT TË ZI

Në mbështetje të pikës 4. të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

URDIËROJ:

1. Hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave", në "Maritime Environmental Protection and Management", me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e përbashkët "Master i Shkencave" në "Maritime Environmental Protection and Management" në Fakultetin e Studimeve Profesionale, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë dhe në Fakultetin e Studimeve Detare, në Universitetin e Malit të Zi. referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e përbashkët të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Maritime Environmental Protection and Management", në Universitetin "Aleksandër Moisiu". Durrës, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë dhe në Universitetin e Malit të Zi. fillon në vitin akademik 2023-2024.
3. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSEHI

